



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 82 paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, neneve 14, 15 paragrafi 2.4, dhe nenin 90 paragrafët 2 dhe 3 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18,

Sipas raportit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr.02-1804-2/21 të datës 08.06.2021, i përcjellur nga Ministria e Pushtetit Lokal përmes Shkresës 020-396/10 të datës 10.06.2021 për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, pas rishqyrtimit të aktit, në mbledhjen e mbajtur më 28 qershor 2021, mori këtë,

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës nr.prot.01-020/04-0035824/21 i datës 29 prill 2021 për plotësimin dhe ndryshimin e përbërjes së Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në “Lagjen e Dëshmorëve” në fshatin Balloc, dhe Vendimi bazë nr.prot.01-020/04-0026812/18 të datës 28 mars 2018 për ngritjen e Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në “Lagjen e Dëshmorëve” në fshatin Balloc.

Neni 2

Shfuqizimi i Vendimeve sipas nenit 1, bëhet për shkak të vlerësimit nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, se janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, dhe se, ndër të tjera, Komisioni dhe kryesuesi i Komisionit ngritët nga Kryetari i Komunës, e jo nga Kuvendi i Komunës (*neni 5 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.22/2010 për procedurat e përfitimit nga Programet e Veçanta të Banimit*)

Neni 3

Vendimi hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës së Podujevës.

Nr.01-020/04-0051839/21
Podujevë,
28 qershor 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neneve 14 dhe 15 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 9 të Rregullores së Kuvendit të Komunës, për caktimin e kriterëve për dhënie të shtëpive në shfrytëzim në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc nr.prot.01-463-45840 të datës 27 maj 2014, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2021, mori këtë,

VENDIM

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, dhe atë;

Ragip Fetahu caktohet anëtar i Komisionit në fjalë, në vend të z.Vendenis Lahu, i cili është zgjedhur Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe nuk është më anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Neni 2

Ky Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit nr.prot.01-020/04-0026812/18 për ngritjen Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc të datës 28 mars 2018.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.01-020/04-0035824/21
Podujevë,
29 prill 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 12.1 dhe 17 shkronja k) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 3 paragrafi 1.3 të Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit nr.03/L-164, nenit 4 të Memorandumit të bashkëpunimit të lidhur mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Podujevës të datës 18 mars 2014, në pajtim me nenin 9 të Rregullores së Kuvendit të Komunës, për caktimin e kritereve për dhënie të shtëpive në shfrytëzim në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc nr.01-463-45840 të datës 27 maj 2014, dhe neneve 15.1 dhe 18 shkronja k) të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2018, mori:

VENDIM

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR NDARJEN E SHTËPIVE NË PRONËSI TË KOMUNËS NË LAGJEN E DËSHMORËVE NË FSHATIN BALLOC

Neni 1

1. Për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, familjeve banuese në lagjen e cekur, përkatësisht familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të luftës së UÇK – së, viktimave civile, familjeve me anëtar me nevoja të veçanta dhe atyre në asistencë sociale, ngritet Komisioni në përbërje:

- Agim Behluli, kryesues, nga Kuvendi i Komunës
- Valbona Kadriu Podvorica, anëtare, nga Kuvendi i Komunës
- Vendenis Lahu, anëtar, nga Kuvendi i Komunës
- Fatmir Rudari, anëtar, nga Kuvendi i Komunës
- Musa Jakupi, anëtar, përfaqësues i Organizatave të dala nga Lufta e UÇK-së.

2. Në cilësinë e vëzhguesit, në punën e Komisionit, merr pjesë përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa zyrtari përkatës për mirëqenie sociale në Komunën e Podujevës ofron ndihmën e nevojshme teknike dhe profesionale varësisht kërkesave të Komisionit.

Neni 2

Komisioni e bënë vlerësimin e gjendjes ekzistuese të banimit në Lagjen e Dëshmorëve, bashkëpunon me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Strukturat e Komunës dhe me përfundimin e ndërtimit të shtëpive e bënë ndarjen e tyre.

Neni 3

Komisioni, në funksion të lirimit të hapësirës për ndërtim të shtëpive, varësisht prej sigurimit të mjeteve financiare nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, vendos për largimin e objekteve aktuale të banimit – kontejnerëve.

Neni 4

Kriteret e ndarjes, mënyra dhe kohëzgjatja e shfrytëzimit të shtëpive si dhe çështje tjera përcaktohen me akt të veçantë të Kuvendit, përkatësisht me Rregulloren e Kuvendit të Komunës, për caktimin e kriterëve për dhënien e shtëpive në shfrytëzim në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc nr.prot.01-463-45840.

Neni 5

Për punën e vet Komisioni i raporton Kuvendit të Komunës.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-020/04-0026812/18
Podujevë,
28 mars 2018



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi